



**Kuvendi i Komunës Klinë**

01Nr prot. 06-3885 2025

Datë: 05.10.2025 2025

**Duke u bazuar në nenin 53, 57, dhe 58 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 publikuar në Gazetën Zyrtare, nr.20/2016, nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronjën c) dhe shkronjën l) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.3/L-040, Nenit 40 nen piken 3 të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim të datës: 20.01.2025 me nr. prot. 01Nr.401-2076/2025, si dhe me Rekomandimet e Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të rregullt për vitin 2025 të mbajtur më datën: 31.01.2025, mori këtë :**

**V E N D I M**

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për ndryshim-plotësim të vendimit 01Nr.06-31721/2020 i miratuar me datë 30.10.2020 për pagesën e shujtave për të gjithë të punësuarit në Administratën e Komunës së Klinës.
2. Me këtë vendim ndryshohet Neni 1 i vendimit bazë, me anë të së cilit pagesa e shujtës ditore ishte e paraparë në vlerë prej 2.50 euro, pas miratimit të propozimit të Ekzekutivit vlera e shujtës ditore ngritet në 4 euro, ndërsa pjesa tjetër e vendimit mbetet e pa ndryshuar.
3. Ky vendim është pjesë vendimit 01Nr.06-31721/2020 i miratuar me datë 30.10.2020 për pagesën e shujtave për të gjithë të punësuarit në Administratën e Komunës së Klinës.
4. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, pagesa e shujtës ditore në vlerë prej 4 euro do të bëhet duke filluar nga muaji Janar 2024.
5. Pagesa e shujtave do të bëhet nga kategoria Paga dhe Mëditje sipas programeve përkatëse.
6. Për ekzekutimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
7. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të cilat janë në fuqi dhe pas publikimit në web faqen zyrtare të komunës.

**Me këtë vendim njoftohen:**

- MAPL;
- Kryetari i Komunës;
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.

**Kryesues i Kuvendit**  
**Fadil Gashi**